




Pranimar / Dorezuar Priljeno / Predato Received / Delivered	28.04	2021	1	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jednica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKIMSHK	2047/2021		1/4	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.145/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti - kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Eshref Shabani anëtar si dhe Zyle Millaku Gojnovci-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën e datës 16.03.2021 me numër A.nr.145/2021 të parashtruar nga ankuesja me adresë rruga "Ilaz Kodra", blloku 7, hyrja 4 nr.17, në Komunë të Prishtinës, kundër organit të punësimit Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, në çështjen juridike "Transferim", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 28.04.2021, mori këtë:

V E N D I M

PËRFUNDON PROCEDIMI ADMINISTRATIV i inicuar me ankesën A.nr.145/2021 të datës 16.03.2021 të parashtruar nga ankuesja

A r s y e t i m

Ankuesja nëpunëse civile në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës me datë 16.03.2021, ka parashtruar ankesë me numër protokolli 1180/2021 të regjistruar me numër A.nr.145/2021, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës, kundër Vendimit numër Ref.45/2020 të datës 23.02.2021 të Zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, për sistemimin e ankueses në pozitën e Drejtore për Studime, Hulumtime dhe Publikime në Akademinë Diplomatike.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil më datë 22.03.2021 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankueses në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës. Më datë 30.03.2021 ka pranuar përgjigje në ankesë nga MPJD-ja se bashku me shkresat e lëndës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në lidhje me këtë lëndë ka administruar këto prova: Ankesën e ankueses parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të

Kosovës më datë 16/03/2021 me numër protokolli: 1180/2021; Vendimin e Zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës me numër Ref.45/2021 të datës 23.02.2021; Vendimin me numër Nr.03/65 të datës 08.03.2021 për Themelimin e Akademisë Diplomatike; Katalogun e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil të Kosovës i plotësuar dhe ndryshuar me titujt e vendeve të punës me vendimin Nr.09 të datës 21.02.2018 nga ministri i Ministrisë së Administratës Publike; Kërkesën e ankueses për mbajtjen e seancës e dërguar përmes E-mailit në adresë elektronike të pranimit të ankesave në Këshill ankesa.kpmschck@rks-gov.net e protokolluar me numër:1412/2021 të datës 26.03.2021; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 22.03.2021 me numër protokolli:1298/2021;Përgjigja në ankesë e datës 30.03.2021 me numër protokolli:1471/2021; Përshkrimi i detyrave të punës për pozitën Drejtor për Studime, Hulumtime dhe Publikime në Akademinë Diplomatike; E-mailin e datës 25.02.2021 dërguar nga .

Krasniqi për me korrespondencën e bashkangjitur prej 2 (dy) faqesh; E-maili i datës 01.02.2021 dërguar nga për më korrespondencën e bashkangjitur prej 3 (tre) faqesh, bashkangjitur Strukturën organizative të Ministrisë se Punëve të Jashtme dhe Diasporës; E-mailin e datës 06.04.2021 Kërkesë për prova shtesë për nga dy faqe bashkangjitur, Përshkrimi i detyrave të punës i datës 17.04.2015 për vendin e punës Udhëheqës i Departamentit për diplomaci Ekonomike; Ndryshim plotësim i Akt emërimit nr.017/2015; Ftesa për seancë dëgjimore e datës 07.04.2021, dërguar përmes E-mail zyrtar të datës 07.04.2021; Konfirmimi për pjesëmarrje në seancë dëgjimore nga ankuesja, përmes E-mailit zyrtar të datë 07.04.2021 si dhe E-maili i datës 08.04.2021 nga organi i punësimit; E-mail i datës 16.04.2021, lista e pozitave të lira; Vendimi A.nr.417/2020 i datës 10.02.2021 i KPMSHCK-së; Procesverbali i seancës dëgjimore i datës 13.04.2021

Kolegji për shqyrtimin e ankesave pas seancës dëgjimore të datës 13.04.2021 dhe pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se objekt për të cilin ka filluar procedimi administrativ sipas ankesës së është shqyrtuar paraprakisht dhe mbi këtë bazë konstaton se janë plotësuar kushtet ligjore që të përfundohet procedimi administrativ, SEPSE:

Bazuar në shkresat e lëndës Kolegji ka konstatuar së ankuesja me datë 16.03.2021, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, kundër Vendimit Nr.ref.45/2021 të datë 23.02.2021 të Zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, lidhur me sistemimin e ankueses në pozitën, Drejtores për Studime, Hulumtime dhe Publikime në Akademinë Diplomatike' 'pas kthimit nga shërbimi diplomatik " Këshilltare" në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Londër.

Këshilli përmes Vendimit me numër A.nr.417/2020 të datës 10.02.2021 ka pranuar pjesërisht si të bazuar ankesën e ankueses të datës 14.12.2020 dhe ka detyruar organin e punësimit, që të sistemoj ankuesen në njërin nga tri pozitave të lira udhëheqëse, të konfirmuara nga MPJD-ja sipas shkresës/emailit të datës 01/02/2021.

Zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës për zbatimin e Vendimit të Këshillit me numër A.nr.417/2020 të datës 10.02.2021,me Vendimin Nr. ref.45/2021 të datës 23.03.2021, ka bërë sistemimin e ankueses në pozitën e Drejtores për Studime, Hulumtime dhe Publikime në Akademinë Diplomatike, duke filluar nga data 23.02.2021.



Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshill e precizuar edhe në seancën dëgjimore të datës 13.04.2021 ka kundërshtuar Vendimin Nr. ref.45/2021 të datës 23.03.2021 të Zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës si dhe Vendimin me numër A.nr.417/2020 të datës 10.02.2021 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me pretendimet ankimore se vendimet e atakuara me ankesë janë në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Rregulloren (QRK) nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civil; Ligjin Nr.06/L-113 për Organizmin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.03/65 të datës 08.03.2012 për Themelimin e Akademisë Diplomatike të Kosovës, si dhe Katalogun e Vendeve të Punës në Shërbimin Civilë, i plotësuar dhe ndryshuar me datë 21.02.2018.

Bazuar në faktin se objekti i ankesës me numër A.nr.145/2011 i datës 16.03.2021, bazohet në të njëjtën gjendje faktike me objektin e ankesës së parashtruar në Këshill me datë 14.12.2020, e për të cilën Këshilli ka vendosur me Vendimin A.nr.417/2020 të datës 10.02.2021, Kolegji në kuptim të dispozitave të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative përkatësisht nenit 101 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 ku përcaktohet se: *1. "Një organ publik përfundon një procedurë administrative, në cilëndo fazë të saj, nëse zbulon se: 1.1. gjatë më pak se dy (2) viteve para datës së parashtrimit të kërkesës, ka vendosur për të njëjtën kërkesë të paraqitur nga pala e njëjtë, me të njëjtin qëllim dhe bazuar mbi të njëjtën situatë faktike"*, ka konstatuar se përfundohet procedimi administrativ i inicuar nga ankuesja Elmaze Pireva, përmes ankesës A.nr.145/201 të datës 16.03.2021.

Bazuar në nenin 21 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ku përcaktohet se: *1. Vendimi i Këshillit është vendim administrativ i formës së prerë dhe zbatohet nga zyrtari i nivelit të lartë drejtues ose personi përgjegjës i institucionit që e ka marrë vendimin e parë ndaj palës dhe nenin 22 ku përcaktohet se: 1. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit të përcaktuar me dispozitat e ligjit për konfliktin administrativ. 2. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e vendimit të Këshillit, Kolegji ka konstatuar se vendimet e KPMSHCK-së janë vendime të ekzekutueshme dhe së pala e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm, ka të drejtë të inicioj konflikt administrativ në gjykatën kompetente, e si rrjedhojë ankuesja kundër Vendimit të Këshillit me numër A.nr.417/2020 të datës 10.02.2021, në rast të pakënaqësisë me këtë vendim, ka mundur të filloj konflikt administrativ ashtu siç është udhëzuar në pjesën e Këshillës Juridike.*

Duke u bazuar në rrethanat specifikuar si më lartë, Kolegji pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë -Departamentin Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda A.nr.145/2021, datë 28.04.2021

Zyle Millaku GOJNOVCI

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Ministrit të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës
- Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës,
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës,
- Arkivit të KPMSHCK-së.

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

